



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "2A" Sh.P.K. të datës 01.02.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "2A" Sh.P.K. e datës 01.02.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "2A" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "2A" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 01.02.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraparak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë ankimor: “Është kriter tendencioz që Inxhinier i diplomuar i hidroteknikes-ekspert per testim te gypave te jete i certifikuar per menaxhim te punishtes- vet termi nenkupton se kete certifikate duhet ta kete udheheqesi i punishtes, dhe inxhinieri i hidroteknikes te jete i certifikuar me ISO OHSAS 18001, pse te jete i kufizuar pikerisht ky inxhinier, mund te kerkohet te jete njeri nga inxhinieret i certifikuar por jo pikerisht inxhinieri i hidroteknikes.”.

Pretendimi i dytë ankimor: “Per të gjithë diplomat-kualifikimet e arritura eshte kerkuar deshmi Diploma (kopje e noterizuar ne Republiken e Kosoves) Kufizimet e tilla si deshmi te jete e noterizuar ne Republiken është në kundërshtim me memorandum bashkëpunimin mes odës së noterëve. Aktet noteriale, siç është noterizimi i dokumenteve, njihen midis shteteve dhe pranohen si prova te ligjshme”.

Sa i përket pretendimit të parë ankimor, fillimisht duhet sqaruar se përveç kërkesës që menaxheri i vendpunishtes të jetë i certifikuar për siguri në punë, është kërkuar që edhe inxhinieri i hidroteknikës duhet të jetë certifikuar me ISO OHSAS 18001. Megjithatë argumenti i parashtruesit se edhe ndonjë nga inxhinierët e tjerë mund të jetë certifikuar është argument i qëndrueshëm. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të dytë ankimor, duhet cekur se kërkesa në dosjen e tenderit i referohet kualifikimeve përkatësisht diplomave të arritura jashtë Republikës së Kosovës. Në këtë rast është e domosdoshme që të dëshmohet nostrifikimi i diplomës së huaj në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 12-2018 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës. Pra në rastin konkret në vend se të përdoret termi “nostrifikim” është përdorur termi “noterizim” në mënyrë të gabuar në dosjen e tenderit. Për këtë arsye pretendimi ankimor është i bazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 09.01.2024

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.